

FJALA E DEPUTETIT FLAMUR NOKA

E ENJTE 20 TETOR 2022

Ky parlament është aq demokratik dhe pluralist aq sa kur na jepet ndonjëherë fjala, duhet t'ju themi: "Faleminderit që kujtoheni të na e jepni fjalën", sepse gjatë gjithë ditës në mënyrë absolute vetëm fjala nuk jepet.

Zonja Kryetare,

Sot në rendin e ditës kishim disa çështje shumë të rëndësishme, por një nga çështjet kryesore ishte çështja e energjisë, për të cilin ishte kërkuar interpelancë nga ana e deputetëve. Çështja për të cilën po flasim tani lidhet me marrëveshjen ndaj sulmeve kibernetike. Faleminderit që nuk ma dhatë fjalën kur ishte ajo pikë, por ma dhatë tani, megjithatë do të përpiqem t'i përmbledh të gjitha së bashku!

Dua t'ju them vetëm një gjë, qytetarët e Shqipërisë kanë nevojë të dinë se cilat janë kompanitë për të cilat janë paguar 195 milionë euro nga qeveria shqiptare me taksat e qytetarëve shqiptarë për të ndërtuar dhe për të mbrojtur sistemet digjitale të Republikës së Shqipërisë.

Kemi zhvilluar një seancë dëgjimore me nëndrejtorin e Shërbimit Informativ Shqiptar, kemi zhvilluar seancë dëgjimore si Komision Sigurie edhe me drejtoreshën e AKSHI-t. Më duhet t'ju them se shërbimi, kreu i shërbimit, kjo është çështje tjetër, por ne jemi i vetmi vend ku me ligj kreu i shërbimit nuk mund të rrijë jashtë shtetit, ka 2 vjet që është jashtë shtetit dhe nuk merret vesh se për çfarë dhe pse (e keni lënë për trajnim), ndërsa këtu komandohet një njeri që ka qenë këshilltar i Kryeministrit, ky është skandal më vete. Shërbimi nuk kishte asnjë informacion dhe nuk e dinte se cilat ishin kompanitë që e kanë ndërtuar sistemin dhe janë paguar për ta mbrojtur atë.

Vjen drejtoresha që ka zhvilluar tenderin, e pranon që ka bërë tenderë dhe që janë zhvilluar tenderë sekretë, por ndërkohë thotë se nuk e di se cilat janë kompanitë që e kanë ndërtuar këtë sistem dhe kanë pasur si detyrë ta mbronin platformën digjitale. E kuptoni apo jo? Informacionet janë që njëra nga kompanitë është e një pronari që ka një gurore në Krujë, ka lidhje me këta këtu mbrapa (informacionet janë që ka një portal ose një media me 4 gazetarë), pra një nga kompanitë që e ka ndërtuar dhe është paguar me miliona euro për ta mbrojtur platformën. Askush nuk di gjë. Është pyetur ministrja, ja ku e keni zonjën ministre, në Komisionin e Sigurisë (dorën e ul, po gishtin jo) dhe ka thënë se nuk di gjë. A mund të na thoni se kush di ndonjë gjë këtu? Qeveria nuk di, instancat e saj nuk dinë, kush mund ta dijë? Cilat janë kompanitë që janë paguar 195 milionë euro, zonjë, shqiptarët i kanë paguar dhe ne ishim të zbuluar totalisht. Për 1 vit e gjysmë hakerat kanë lundruar në të dhënat e çdo shqiptari dhe tani tallen me ne.

Ju e keni ditur, nuk besoj se keni qenë të paditur, se që nga dita që ne e kemi pranuar opozitën e Iranit në Shqipëri do të ishim në sulm. E keni ditur besoj se qeveria islamike e Iranit, si qeveri armike, është një nga qeveritë që investon më së shumti në këto sisteme dhe në çështjet e hakerimit. Nuk keni marrë asnjë masë dhe paratë janë bërë rrush e kumbulla: vidh me inceneratorët, i bëtë të vdekurit milionerë, ndjesë paçin, se janë emra të vdekurish, por numrat e llogarisë i kanë ministrat e qeverisë, i bëtë pensionistët që ishin duke ruajtur dhitë në Athinë milionerë në llogari, ndërkohë që ishin pa bukë atje, nuk latë gjë pa

bërë! Babëzi të tilla nuk kam parë, por duhet t'ua keni borxh shqiptarëve, të cilëve u janë nxjerrë të gjitha të dhënat dhe ua merr shteti terrorist i Iranit. Tani nuk u thoni shqiptarëve se cilat janë kompanitë.

Pyetja e vetme që unë kam është: cilat janë kompanitë dhe pse fshihen? Pse, zonjë, i trembeni publikimit të këtyre emrave si djalli temjanit? Çfarë fshihet pas kësaj? Cili nga ministrat apo nga personalitetet e maxhorancës fshihet pas kësaj?

Siç jua thashë, informacionet janë që gurorja me punëtorë është paguar për të ngritur dhe për të mbrojtur platformën digjitale të këtij vendi. Pse nuk e thoni? Kaq, asgjë më shumë. Ne nuk presim që ju të merrni masa, jo, sepse për ju vriten njerëz, madje bëhen edhe filma sipas jush, vidhen miliona dhe bëhen filma për ju, ndodh çdo gjë, sepse për ju nuk ka asnjë gjë të papranueshme dhe asgjë që nuk quhet normale, për ju çdo gjë është normale, por për shqiptarët jo. Pse keni këtë frikë ta thoni? Jua them unë, se një nga firmat lidhet me Kryeministrin, dy nga këto lidhen me ministrat e kabinetit. Janë pa asnjë eksperiencë dhe pa asnjë përvojë, por paguhen. Një nga këto është e famshme e Beqes. Po ju nuk guxonit të flisni, sepse dihet se çfarë keni, keni vetëm vjedhje, vjedhje, vjedhje.

Çfarë ndodhi mbrëmë? U vra një qytetar i këtij vendi. Me vrap rendi shteti, por jo për të zbuluar autorin, jo për të zbuluar ngjarjen dhe për t'u thënë shqiptarëve të vërtetën. Me vrap kryehorri Ardi Veliu, siç bëri me Klodian Rashën, siç bëri me ngjarjen e Elbasanit për të falsifikuar, mbuluar dhe fshehur të vërtetën, ashtu edhe në këtë rast me vrap rendi për ta fshehur vrasjen. Personi ka shkuar i vdekur në spital, raporti i Spitalit Ushtarak e vërteton këtë, ka shkuar i vdekur, i vlarë nga policia. Dhe ju bëni strucin duke u fshehur dhe i lini kamikazët tuaj të shkatërrojnë provat e krimit dhe të tentojnë të mashtrojnë shqiptarët. Është vrasje dhe keni pafytyrësinë të mos mbani një minutë heshtje për një të ri shqiptar që është vlarë nga dora e shtetit. E ka vlarë shteti, e keni vlarë ju. Kjo është fytyra juaj dhe ju pastaj mundoheni të na tregoni përralla, dokrra, histori dhe tërr-mërre.

Ju siguroj se protesta do t'ju fshijë, revolta e qytetarëve do t'ju fshijë. Bëni çfarë të doni e si të doni, sepse çdo shqiptari i ka ardhur në majë të hundës. Mos mendoni se jeni aq të zotë që të përzini çdo shqiptar dhe të mbani veç patronazhistët, sepse ky është qëllimi dhe strategjia juaj, që në Shqipëri të mbeteni ju dhe patronazhistët tuaj dhe të sillni skllëvër nga Bangladeshi.

Zgërdhihu ti, zgërdhihu, se ke për ta parë! Ato 5 milionë eurot e doganës do të të dalin për hundësh.

Kjo është koha e shqiptarëve, nuk është koha juaj. Koha juaj si hajdutë të paprincipitë të pakufi do të marrë fund. Çdo gjë që të bëni, nuk keni shpëtim. Koha e shqiptarëve po troket. Ju duhet të jepni llogari, ju dhe e gjithë kjo çetë hajdutësh çetë banditësh dhe narkomanësh këtu pas meje do të japë llogari. Faleminderit!